



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 60

Prishtinë, më 9.12.2016 në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Agim Çeku, Kimete Bytyçi, Ali Berisha, Fisnik Ismaili, Qerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi.

Munguan: Mufera Shinik, Jasmina Zhivkoviç, Milka Vuletiç, Sasha Milosavleviç dhe Slavko Simiq.

Pjesëmarrës të tjerë: përfaqësues nga OSBE-ja, Sanije Berisha; përfaqësuese nga KDI-ja, Agnesa Haxhiu; konsultante e Sekretariatit të KKK-së, Zijush Ahmeti dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Agim Çeku**, nënkryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura të Komisionit më: 19.10.2016 dhe 16.11.2016;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/ L- L- 043 për faljen e borxheve publike me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa.
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-075, për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Agim Çeku, nënkryetar i Komisionit, konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura të Komisionit më: 19.10.2016 dhe 16.11.2016

Nënkryetari, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 19.10.2016 dhe 16.11.2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/ L- L-043 për faljen e borxheve publike me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa.

Nënkryetari paraqiti për shqyrtim Projektligjit nr. 05/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/ L- L-043 për faljen e borxheve publike me raport amendamente të Komisionit FunkSIONAL dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesi konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/ L- L-043 për faljen e borxheve publike dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Nënkryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjit nr. 05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive me raport amendamente të Komisionit FunkSIONAL dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Pas shqyrtimit të projektligjit dhe raportit me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

5. Të ndryshme

Nënkryetari, kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse janë të interesuar të shqyrtohet ndonjë temë tjetër me rëndësi.

Qerim Bajrami, e njoftoi Komisionin se grupi punues ka realizuar të gjitha fazat e monitorimit të Ligjit për Shërbimin Civil, ku është bërë verifikimi i shkallës së zbatimit të nenit 11 të këtij Ligj. Kryesisht, është bërë vlerësimi i gjendjes momentale mbi përfaqësimin e drejtë dhe proporcional të komuniteteve në sektorin publik në nivelin qendror dhe lokal.

Gjegjësisht, jemi në periudhën e finalizimit të draft -raportit, me mundësi që në afat sa më të shkurtë të plotësohet me rekomandimet e dhëna nga kryesuesi i GP, Veton Berisha. Me këtë rast, shpreh qëndrimin e tij që në takimin e radhës, Komisioni të shqyrtojë draft- raportin me rekomandime në funksion të mbikëqyrjes dhe zbatimit të këtij Ligji. Ishte i mendimit, që pasi Komisioni të miratojë raportin me rekomandime dhe i njëjti të procedohet për miratim në Kryesinë e Kuvendit.

Veton Berisha, gjatë fazave të procesit të monitorimit të këtij Ligji, grupin punues e kanë mbështetur stafin për mbështetje të Komisionit dhe partneri i OSBE-së.

Në fazën e dytë të këtij procesi, Komisioni ka kërkuar hulumtim parlamentar nga KDI-a, me temën: “Përfaqësimi i komuniteteve jo shumicë në shërbimin shtetëror të Kosovës”. Për anëtarët e grupit punues ky raport ka qenë udhërrëfyes për të analizuar gjendjen reale të përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë në institucionet e nivelit qendror dhe lokal.

Para një jave i ka dorëzuar raportin me rekomandime pran zyrës së administratës së Komisionit dhe ka kërkuar që i njëjti t’iu dërgohet në mënyrë elektronike anëtarëve të Komisionit për vlerësim. Propozoi që në mbledhjen e radhës të shqyrtohet raporti me rekomandime dhe i njëjti të procedohet për miratim në Kuvend.

Nënkryetari, theksoi se grupi punues ka proceduar të gjitha aktivitetet e planifikuara në kuadër të përgjegjësive për mbikëqyrjen dhe zbatimin e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe ka përpiluar draft - raportin për mbikëqyrje e zbatimit të nenit 11 të këtij Ligji. Në bazë të respektimit të procedurave, Komisioni do të mbajë mbledhje të rregullt, me temën: Shqyrtimi i draft-raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të nenit 11, të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës. Pas miratimit të raportit me rekomandime për nivelin e zbatimit të Ligjit, i njëjti do të procedohet në Kryesi dhe në Seancën Plenare të Kuvendit të Kosovës, për miratim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit.

Nënkryetar i Komisionit,

Agim Çeku